



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI TEKNIK  
DREJTORIA E TARIFËS DHE ORIGJINËS

Nr. 1738 Prot.

Tiranë më 24.01.2018

URDHËR

Nr. 09, datë 24.01.2018.

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI EKSPORTUESIT E MIRATUAR”

Në mbështetje të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar” VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, detyrimeve që rrjedhin nga konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, pikës 1(b)(i), të Pjesës VIII/1, të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e Administratës Doganore”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Mbi eksportuesit e miratuar”.
2. Rregullorja e DPD nr. 01 datë 21.05.2013 “Mbi eksportuesit e miratuar” shfuqizohet.
3. Ngarkohen strukturat doganore dhe operatorët ekonomikë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Belinda Ikonomi

## RREGULLORE

### “MBI EKSPORTUESIT E MIRATUAR”

#### 1. PARIME TË PËRGJITHSHME

##### 1.1. Qëllimi

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me qëllim zhvillimin e një klime sa më të favorshme për operatorët ekonomikë në drejtim të lehtësimit të procedurave të lëshimit dhe verifikimit të provave të origjinës, reduktimin e kostove administrative dhe kohës së përpunimit të mjeteve në doganë mund të autorizojë dhënien e statusit të eksportuesit të miratuar.
- Dhënia e këtij statusi nënkupton që kompanitë të cilat plotësojnë kushtet e përcaktuara në dispozitat e origjinës të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat janë lidhur nga Republika e Shqipërisë, mund të provojnë origjinën preferenciale të mallrave të tyre në eksport apo në retrospektivë me anë të shënimit përkatës në faturë apo në ndonjë dokument tjetër tregtar ku përshkruhen produktet me detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar.
- Ky autorizim i mundëson kompanisë vërtetimin e origjinës preferenciale të mallrave në eksport nëpërmjet deklaratës-faturë/deklaratës-origjinë drejt vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë zbaton Marrëveshje të Tregtisë së Lirë si: vendeve anëtare të Bashkimit Europian, vendeve të CEFTA 2006, vendeve të EFTA-s, Republikës së Turqisë, si edhe vendeve me të cilat mund të zbatohen marrëveshje ndërkombëtare në të ardhmen.

##### 1.2. Baza ligjore

- Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”;
- Vendimi nr.651, datë 10.11.2017 i Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
- Konventa Rajonale për Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të Origjinës, miratuar me ligjin nr. 1/2012, datë 26.01.2012, Shtojca I;
- MSA, miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare, Protokolli 4;
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore CEFTA – 2006, miratuar me ligjin nr. 9696, datë 21.3.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore”, Aneksi 4;
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë midis Republikës së Shqipërisë dhe Turqisë, miratuar me ligjin nr. 9733, datë 14.5.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë”, Protokolli II;
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA, miratuar me ligjin nr. 10288, datë 17.6.2010 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA dhe të Marrëveshjeve për Bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës dhe Principatës së

Lihtenshtejnit, Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë dhe Republikës së Shqipërisë e Republikës së Islandës”, si pjesë përbërëse të saj, Protokolli B.

## **2. APLIKIMI PËR PAJISJEN ME STATUSIN E EKSPORTUESIT TË MIRATUAR**

**2.1.** Operatori ekonomik për pajisjen me statusin e eksportuesit të miratuar plotëson formularin tip të “Aplikimit për Statusin e Eksportuesit të Miratuar” sipas *aneksit 1, të kësaj rregulloreje*. Formulari i Aplikimit mund të plotësohet direkt në faqen web: [www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al),  
*rubrika: Eksportuesi i Miratuar.*

**2.2.** Formularit të aplikimit i bashkëngjitet dokumentacioni i kërkuar në pikën 6 të aneksit 1, si dhe dokumentacioni shtesë për argumentimin e përfitimit të origjinës preferenciale të mallrave.

**2.3.** Formulari i aplikimit së bashku me dokumentacionin përkatës depozitohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

## **3. KRITERET PËR MIRATIMIN E STATUSIT TË EKSPORTUESIT TË MIRATUAR**

**3.1.** Operatori ekonomik që aplikon për statusin e “Eksportuesit të Miratuar”, përveç kushteve të përcaktuara në shkronjat, “a”, “b”, dhe “c” të nenit 19, të vendimit që miraton dispozitat zbatuese të Kodit Doganor duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) Të ketë eksportuar mallra me origjinë preferenciale, me prova të origjinës preferenciale për një periudhë prej minimumi dy vjet nga data e kërkesës;
- b) Të ketë një frekuencë prej minimumi 1 ngarkesë për eksport në muaj ose 12 eksporte në vit;
- c) Të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar statusin e origjinës së mallrave;
- ç) Të lejojë inspektimin e llogarive financiare si dhe çdo kontroll dokumentar dhe fizik që konsiderohet i nevojshëm nga autoritetet doganore lidhur me provat e origjinës;
- d) Të ketë të punësuar të paktën një punonjës që ka njohuri mbi rregullat e origjinës;
- dh) Të mos ketë pasur asnjë rast të kontestuar për provat e origjinës, të përdorura prej tij në eksport, nga doganat homologe gjatë dy viteve nga data e kërkesës;
- e) Në momentin e aplikimit për marrjen e statusit të “Eksportuesit të Miratuar” të mos ketë asnjë detyrim doganor të papaguar.

## **4. MIRATIMI I STATUSIT TË EKSPORTUESIT TË MIRATUAR**

**4.1.** Me marrjen e aplikimit, DPD (Sektori i Origjinës në Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës) verifikon nëse janë përmbushur kushtet për pranimin e aplikimit.

**4.2.** Pa rënë ndesh me afatet përkatëse ligjore për marrjen e vendimit, sipas nenit 27, të Kodit Doganor, kur nuk janë përmbushur kushtet, DPD informon operatorin ekonomik lidhur me mos pranimin e aplikimit duke dhënë arsyet.

**4.3.** Nëse kushtet për pranimin e aplikimit janë përmbushur, kërkon mendim nga dega doganore

mbikëqyrëse (në kompetencën territoriale të së cilës operatori ekonomik zhvillon aktivitetin tregtar). Në rastet kur operatori i kryen eksportet në disa degë doganore atëherë dega e doganës mbikëqyrëse i kërkon i këtyre degëve informacion mbi aktivitetin tregtar të kompanisë.

4.4. Dega doganore mbikëqyrëse pasi kryen verifikimet lidhur me aktivitetin eksportues të kompanisë për mallrat me origjinë preferenciale, brenda 30 ditësh, jep mendimin e saj mbi aktivitetin e operatorit ekonomik (kompanisë), nëse mund të miratohet dhënia e statusit apo ka rezerva mbi të, duke paraqitur një raport të detajuar mbi aktivitetin eksportues të kompanisë.

4.5. Sektori i origjinës pranë DPD në bashkëpunim me doganierët e kontrollit pas zhdoganimit pranë degës doganore mbikëqyrëse, mund të kryejë kontrolle në ambientet e prodhuesit/eksportuesit lidhur me zbatimin korrekt të rregullave të origjinës për mallrat e kërkuara në aplikim.

4.6. Nëqoftëse janë plotësuar të gjitha pikat e sipërpërmendura DPD i jep aplikuesit statusin e eksportuesit të miratuar, duke lëshuar autorizimin sipas modelit të *aneksit 2 të kësaj rregulloreje*.

4.7. Nëse nuk janë plotësuar të gjitha pikat e sipërpërmendura në përputhje me pikat 6 dhe 7 të nenit 27 të Kodit, DPD kthen përgjigje duke argumentuar arsyet.

## 5. NUMRI I EKSPORTUESIT TË MIRATUAR

5.1. Eksportuesi i miratuar pajiset me një numër identifikues, i cili paraqitet në shënimin e specifikuar në faturë.

5.2. Numri identifikues është i ndërtuar si më poshtë:

AL/XX/XXXXXX/XX:

AL: Kodi i Shqipërisë sipas ISO Alpha

2 karaktere: Nr. i Autorizimit

6 karaktere: Kodi i Doganës Mbikëqyrëse

2 karaktere: Viti i lëshimit të Autorizimit

5.3. Një shënim jo i saktë i numrit të autorizimit në deklaratën-faturë/deklaratën-origjinë mund të çojë në kërkesa për kontrolle nga autoritetet doganore homologe dhe madje mund të sjellë edhe refuzimin e preferencës nga vendi partner.

## 6. VLEFSHMËRIA E STATUSIT TË EKSPORTUESIT TË MIRATUAR

6.1. Autorizimi i eksportuesit të miratuar lidhur me deklaratën e origjinës preferenciale është i vlefshëm për të gjitha eksportet në vendet apo grupimet e vendeve me të cilat RSH zbaton marrëveshje ndërkombëtare.

6.2. Autorizimi i eksportuesit të miratuar nuk ka kufizim në kohë.

6.3. Në rastet e hyrjes në fuqi të një marrëveshjeje të re ndërkombëtare, eksportuesi i miratuar me qëllim përfitimin nga statusi i ri preferencial në vendin e ri partner, duhet të paraqesë një kërkesë pranë DPD për përfshirjen e këtij vendi apo grupi vendesh në autorizim.

## 7. PËRJASHTIMI NGA NËNSHKRIMI

Eksportuesi i miratuar nuk është i detyruar të firmosë deklaratën-faturë/deklaratën-origjinë me kusht që ai t'i ketë dhënë autoriteteve doganore një deklaratë me shkrim ku ai pranon përgjegjësinë e plotë për çdo deklaratë-faturë/deklaratë-origjinë, e cila e identifikon atë si të ishte firmosur me dorë prej tij, duke plotësuar pikën 9 në formularin tip të "Aplikimit për Statusin e Eksportuesit të Miratuar" sipas aneksit 1, të kësaj rregulloreje.

## 8. NJOHJA E RREGULLAVE TË ORIGJINËS

Operatori ekonomik eksportues duhet të sigurohet që personi përgjegjës për lëshimin e origjinës preferenciale në deklaratat-faturë/ deklaratat-origjinë të ketë njohuri mbi rregullat e origjinës, sepse vetëm atëherë garantohen detyrimet e eksportuesit.

## 9. DETYRIMET E EKSPORTUESIT TË MIRATUAR

Eksportuesi i miratuar duhet:

- a) të sigurojë përdorimin e këtij statusi vetëm për mallrat me origjinë preferenciale, të cilat i prodhon dhe eksporton ai vetë, ose kur plotësohen kushtet e vendosura në marrëveshje dhe në momentin e lëshimit të deklaratës së origjinës, eksportuesi i miratuar duhet të ketë të gjitha dokumentat e nevojshme, veçanërisht deklaratat e furnitorit për mallrat me origjinë preferenciale;
- b) të sigurojë që deklarimi i origjinës të jepet në një faturë, një notë shpërndarëse apo një dokument tjetër tregtar, ku të përshkruhen produktet me detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar; dhe deklarimi të bëhet sipas tekstit të përcaktuar në protokollat e origjinës të marrëveshjeve ndërkombëtare;
- c) të ruajë për të paktën tre vjet kopjet e deklaratave-faturë/deklaratave-origjinë;
- ç) të lejojë autoritetet doganore të kryejnë inspektim të llogarive financiare, dhe t'i sigurojë atyre kur është e nevojshme prova shtesë;
- d) të njoftojë brenda një muaji Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për ndryshime në proceset e prodhimit, lëndës së parë të importuar apo kushteve të rregullave të origjinës, nëse ka ndryshime të emrit apo formës ligjore të kompanisë dhe për të gjithë faktorët e dalë pas dhënies së autorizimit, të cilët mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbytjen e tij;
- dh) në fund të çdo viti (nga data e miratimit), duhet të paraqesë pranë degës doganore mbikëqyrëse një raport informues lidhur me deklaratat-faturë/deklaratat-origjinë të lëshuara për mallrat e eksportuara;
- e) të sigurojë ndalimin e përjashtimit nga detyrimet doganore, të materialeve jo-origjinuese të përdorura në prodhimin e produktit final origjinues në Shqipëri;
- ë) të sigurojë që transporti i mallrave me origjinë preferenciale të jetë i tillë, që të plotësojë kërkesat e transportit të drejtpërdrejtë;
- f) të mbajë përgjegjësi të plotë për përdorimin e Autorizimit.

## 10. DETYRIMET E DEGËS DOGANORE MBIKËQYRËSE

10.1. Dega doganore mbikëqyrëse sjell mendimin e saj lidhur me miratimin apo mos-miratimin për dhënien e Statusit të Eksportuesit të Miratuar brenda 30 ditësh nga data e marrjes së kërkesës.

10.2. Në përputhje me nenin 28 të Kodit Doganor, Dega doganore mbikëqyrëse duhet të zbatojë kontrolle të rregullta mbi eksportuesin e miratuar. Këto kontrolle duhet të sigurojnë që autorizimi i marrë po përdoret sipas kriterëve të caktuara në autorizim. Kontrollët duhet të kryhen në mënyrë periodike, kryesisht në bazën e kriterëve të analizës së riskut.

10.3. Në rastet e mos plotësisimit nga eksportuesi i miratuar të detyrimeve që rrjedhin nga autorizimi si rezultat i monitorimeve të kryera, dega doganore mbikëqyrëse kërkon pranë DPD, rishikimin e vlefshmërisë së këtij autorizimi, sipas përcaktimeve të Kodit dhe të dispozitave zbatuese.

## 11. PEZULLIMI DHE REVOKIMI, ANULIMI I AUTORIZIMIT DHE SANKSIONET

11.1. Në mbështetje të nenit 31 të Kodit Doganor, kur autorizimi i dhënë ndaj eksportuesit të miratuar është i pasaktë ose i paplotë dhe personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni për këtë fakt, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e anulon atë.

11.2. Në raste të veçanta, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund ta pezullojë autorizimin e dhënë nëse nuk është rasti për ta anuluar, revokuar ose ndryshuar atë, deri në 30 ditë kur:

- a) kërkesa e degës së doganës mbikëqyrëse nuk përmban elementet e nevojshme për të vendosur mbi anulimin, revokimin apo ndryshimin e vendimit;
- b) për t'i dhënë kohë eksportuesit të miratuar për të marrë masa për përmbushjen e kushteve ose respektimin e detyrimeve;
- c) eksportuesi i miratuar kërkon pezullimin përkohësisht të autorizimit dhe informon për masat që do të marrë për të siguruar përmbushjen e kushteve ose respektimin e detyrimeve, si dhe periudhën e kohës që i nevojitet për të marrë këto masa. Periudha e pezullimit, mund të zgjatet edhe 30 ditë më tej me kërkesë të eksportuesit të miratuar.

Pezullimi i autorizimit përfundon sipas afateve dhe situatave të përcaktuara në nenin 26 të VKM nr.651, datë 10.11.2017.

11.3. Në raste të veçanta, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në përputhje me nenin 26 të VKM nr.651, datë 10.11.2017 mund ta rivlerësojë autorizimin e dhënë, në rastet e mëposhtme:

- a) kur ka ndryshime në legjislacionin përkatës, që ndikojnë në vendim;
- b) kur është e nevojshme, si rezultat i monitorimit të kryer;
- c) kur është e nevojshme, për shkak të informacionit të dhënë nga mbajtësi i vendimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 28, të Kodit, ose nga autoritetet e tjera.

11.4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave revokon ose ndryshon autorizimin e pezulluar në

rastet e përmendura në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 11.2., kur eksportuesi i miratuar nuk merr brenda afatit masat e nevojshme për të përmbushur kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në autorizim.

**11.5.** Në përputhje me nenin 28, të Kodit Doganor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka lëshuar autorizimin, mund në çdo kohë ta anulojë, ta ndryshojë ose ta revokojë atë kur ai nuk është në përputhje me legjislacionin doganor.

**11.6.** Për lëshimin e deklaratave të origjinës në mënyrë jo të rregullt, operatori ekonomik mban përgjegjësi dhe ndaj tij zbatohen sanksionet e parashikuara në Kodin Doganor, Dispozitat Zbatuese të tij si dhe në akte të tjera ndërkombëtare detyruese për vendin tonë.